



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK TË
USHTRUAR NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-6
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II.	HYRJA	
II.1.	Objekti i auditimit	6-9
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	9-27
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	9-10
III.2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
III.2.1	Procedurën e ndjekur, nga marrja e njoftimit nëpërmjet Sistemit RASFF (Sistemi i informimit të shpejtë për ushqim dhe ushqim për kafshë) për përdorimin e paautorizuar të substancës ÷oksid etileni÷ në prodhimin e produktit ÷Akullorë÷ (importuar dhe tregëtuar në tregun Shqiptar), deri në inspektimin, bllokimin, tërheqjen nga tregu dhe asgjësimin e saj.	10-27
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	27-28
V.	ANEKSE	29-33



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DPAKU), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme zbatimit të kuadrit rregullator përkatës, në procedurën e ndjekur nga marrja e njoftimit nëpërmjet Sistemit RASFF (Sistemi i informimit të shpejtë për ushqim dhe ushqim për kafshë) për përdorimin e paautorizuar të substancës ÷oksid etileni÷ në prodhimin e produktit ÷Akullorë÷ (importuar dhe tregtuar në tregun Shqiptar), deri në inspektimin, bllokimin, tërheqjen nga tregu dhe asgjësimin e sajë.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 31.08.2021 deri më datë 07.09.2021, grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 27.07.2021 deri 23.08.2021.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 2 akt-konstatime. Në përfundim të punës audituese në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e DPAKU Tiranë. Mbi aktet e mbajtura dhe Projekt Raportin e grupit të auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur nga grupi i auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim të auditimit rezultoi:

-Sektori i informimit të shpejtë dhe mbikëqyrjes së tregut (sektori i aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF) në dy raste, nuk ka përcjell njoftimin e datës 27.07.2021 ora 15:58 dhe datës 29.07.2021 të RASFF, strukturave përgjegjëse të AKU-së;

-AKU deri në përfundim të periudhës së auditimit datë 07.09.2021, nuk pati evidence mbi informimin e publikut, në lidhje me sigurinë ushqimore për produktet që kanë qarkulluar me probleme, sipas njoftimit të RASFF;

-Nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU nuk është nxjerrë urdhër i brendshëm për 12 Drejtoritë Rajonale të Ushqimit, me qëllim kryerjen e inspektimeve dhe ndjekjen e gjurmueshmërisë së produktit ÷Akullorë÷ deri tek subjektet fundore të furnizuara me këtë produkt;

-Nga përllogaritja e grupit të auditimit të KLSH, të sasisë së importuar rezulton se janë importuar 2.7 Ton më shumë akullore, nga deklarimi i bërë nga AKU;

-Nga përllogaritja e grupit të auditimit të KLSH, të sasisë së konsumuar rezulton se janë konsumuar 2 Ton më shumë akullore, nga deklarimi i bërë nga AKU.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i dy procedurave respektivisht të datës 16.08.2021 dhe të datës 19.08.2021, për asgjësimin e produktit ÷akullorë÷ dhe depozitimin e mbetjeve të tyre në landfillin e Bushatit u konstatuan veprime në kundërshtim me nenin 69, të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 ÷Për ushqimin÷, i ndryshuar dhe shtojcën 2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 10.8.2018 ÷Për miratimin e rregullores, ÷Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ÷, pasi në të dy rastet nuk administrohet dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas kërkesave të pikës 4, të VKM nr.229, datë 23.04.2014 ÷Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme÷, si dhe kërkesave të Kreut VIII të VKM nr.452, datë 11.7.2012 ÷Për lëndfillet e mbetjeve÷, i ndryshuar, në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin, pra	Faqe 10-27	E lartë	DPAKU të marrë masat e nevojshme që, çdo procedurë asgjësimi të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve të jenë: Procesverbali i asgjësimit i mbajtur nga inspektorët e tatimeve, mjedisit dhe ushqimit; Dokumenti i transferimit të mbetjeve; Fletë-dalja nga magazina e subjektit privat, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill. Në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
2	<p>personi përgjegjës në landfillin e Bushatit.</p> <p>Nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU nuk është nxjerrë urdhër i brendshëm për 12 Drejtoritë Rajonale të Ushqimit, me qëllim kryerjen e inspektimeve dhe ndjekjen e gjurmueshmërisë së produktit òakullorëo deri tek subjektet e furnizuara me këtë produkt. Mosveprim i cili bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 12 dhe 15 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 6, në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqiminò, i ndryshuar, shkronjën òaò në pikën 2 të nenit 4, shkronjën òcò dhe òçò të pikës 1 në nenin 25, pikën 1 të nenit 27, shkronjën òaò të pikës 1 në nenin 33, në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò, pikën 3 në Kreun I, shkronjën òbò të Kreut II, shkronjat òfò dhe òkò të pikës 8 të Kreut III, shkronjën òbò në pikën 13 të Kreut III në VKM nr.708, datë 09.09.2020, òPër organizimin dhe funksionimin e AKU-sëò dhe pikën 2 në Kreun VI të VKM nr.760, datë 16.9.2015 òPër kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimorò.</p>	Faqe 10-27	E lartë	<p>Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, të marrë masat e nevojshme që, për çdo rast të njoftimeve òAlertò me risk serioz për sigurinë e produkteve ushqimore, duke vlerësuar përhapjen në treg të produktit dhe gjurmueshmërinë e tij, të nxjerrë urdhër të brendshëm për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar të inspektimeve. Gjithashtu të merren masa për përmirësimin dhe hartimin e rregullores òPër procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFFò duke reflektuar strukturën e re organizative të AKU-së dhe në përputhje me standardet e direktivës së fundit të BE për sistemin RASFF.</p> <p>Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vijimësi</p>

I.3. Konkluzioni i auditimit¹.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për periudhën nga data 27.07.2021 deri më datë 23.08.2021, me ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqiminò, i ndryshuar dhe ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Në konkluzionin tonë, bazuar në punën e kryer të auditimit, ka rezultuar se aktiviteti i DPAKU përgjatë periudhës 27.07.2021 deri më datë 23.08.2021, mbi procedurën e ndjekur nga marrja e njoftimit nëpërmjet Sistemit RASFF (Sistemi i informimit të shpejtë për ushqim dhe ushqim për kafshë) për përdorimin e paautorizuar të substancës òoksid etileniò në prodhimin e produktit òakullorëo (importuar dhe tregtuar në tregun Shqiptar), deri në inspektimin, bllokimin, tërheqjen nga tregu dhe asgjësimin e sajò, **nuk ka qenë efektiv**, si dhe **rezultuan** devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret), si pasojë e mospërbushjes së detyrave funksionale të institucionit të audituar.

Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për arritjen e këtij konkluzioni.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin Nr.154/2014, datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Autorizimit nr.979, datë 31.08.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 31.08.2021 deri në datë 07.09.2021, në subjektin, Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (në vijim DPAKU) për periudhën nga 27.07.2021 deri 23.08.2021 u krye auditimi tematik òMbi procedurën e ndjekur nga DPAKU, nga marrja e njoftimit nëpërmjet Sistemit RASFF (Sistemi i informimit të shpejtë për ushqim dhe ushqim për kafshë) për

¹ Sipas Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020, pika 2.5, òAngazhimet e raportimit të drejtpërdrejtò - Në një angazhim të raportimit të drejtpërdrejtë është audituesi që mat ose vlerëson çështjen që auditohet në lidhje me kriteret. Audituesi përzgjedh se çfarë do të auditojë përcakton kriteret duke marrë parasysh riskun dhe materialitetin. Duke krahasuar evidencat e që i përkasin çështjes që auditon kundrejt kriterëve të vendosura, audituesi është në gjendje të formulojë një konkluzion.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

përdorimin e paautorizuar të substancës oksid etileni në prodhimin e produktit òAkullorë (importuar dhe tregtuar në tregun Shqiptar), deri në inspektimin, bllokimin, tërheqjen nga tregu dhe asgjësimin e saj, nga

Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K.K., auditues, përgjegjës grupi
2. A.L., auditues, anëtar

II.1. Objektivi i auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer auditimin tematik mbi mbi procedurën e ndjekur, nga marrja e njoftimit nëpërmjet Sistemit RASFF (Sistemi i informimit të shpejtë për ushqim dhe ushqim për kafshë) për përdorimin e paautorizuar të substancës oksid etileni në prodhimin e produktit òAkullorë (importuar dhe tregtuar në tregun Shqiptar), deri në inspektimin, bllokimin, tërheqjen nga tregu dhe asgjësimin e saj, ku objektivi i auditimit ishte: òDhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve.

Gjatë ushtrimit të auditimit tematik, objektivi i auditimit është përqendrimi i auditimit në çështje, problematika, tematika, apo sektorë specifikë, dhënia e opinionit nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti i subjektit të audituar është në përputhje ose jo me dispozitat dhe rregulloret përkatëse.

II.2. Qëllimi i auditimit.

-Ky auditim ka si qëllim: Raportimin dhe evidentimin e gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e procedurës së reagimit të DPAKU në raste të tilla, në të ardhmen.

-Fushëveprimi i auditimit: Veprimtaria audituese në auditimin e DPAKU, përfshiu periudhën e audituar nga data 27.07.2021 deri 23.08.2021.

II.3. Identifikimi i çështjes.

DPAKU, duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj taksapaguesit, duke pasur në fokus kryesor, garantimin e ushqimit të sigurt dhe cilësor. Auditimi u fokusua në procedurën e ndjekur nga DPAKU, nga marrja e njoftimit nëpërmjet Sistemit RASFF (Sistemi i informimit të shpejtë për ushqim dhe ushqim për kafshë) për përdorimin e paautorizuar të substancës oksid etileni në prodhimin e produktit òAkullorë (importuar dhe tregtuar në tregun Shqiptar), deri në inspektimin, bllokimin, tërheqjen nga tregu dhe asgjësimin e saj.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

DPAKU niveli drejtues i saj (Drejtori i Përgjithshëm, Kryeinspektor i Drejtorisë Rajonale të AKU-së, si dhe niveli i mesëm drejtues) kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, marrjen e masave parandaluese, gjurmimin e produktit ushqimor në çdo fazë të tregëtimit të tij, deri tek konsumatori final, me qëllim garantimin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve me origjinë shtazore, që qarkullojnë në tregun e brendshëm.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjen që është nën auditim. Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

II.6. Kriteret e vlerësimit.

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Lloji i dokumentit	Detajet e bazës ligjore dhe rregullore
Standarde auditimi dhe kuadri ligjor i KLSH:	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Ligji nr.154/2014 òPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; Rregullore e Brendshme òMbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.85, datë 30.06.2015, i ndryshuar; Rregullore òMbi Procedurat e auditimit në KLSH, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar.
Ligje:	Ligji nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqimin, i ndryshuar; Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisë.
Vendime të Këshillimit të Ministrave (VKM)	VKM nr.708 datë 09.09.2020, òPër organizimin dhe funksionimin e AKU-së; VKM nr.760, datë 16.9.2015 òPër kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor; VKM nr.229, datë 23.04.2014 òPër miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme.
Akte të tjera nën ligjore:	Urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 10.8.2018 òPër miratimin e rregullore, òPër përcaktimin e procedurës së inspektiveve, si një proces i rregullt administrativ; Rregullore e brendshme e AKU-së. Rregullore e RASFF.

II.7. Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

II.8. Metodatat e auditimit.

- Verifikimi i dokumentacionit;
- Rillogaritja/kontrolli aritmetik i sasisë së importuar, shitur dhe kthyer nga tregu, si dhe asgjësuar;
- Kryqëzimi i të dhënave.

II.9. Dokumentimi i auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve të gjithsej, Projekt Raportit të Auditimit, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Raporti Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Vlerësimi i **riskut**, në auditimet e tematike (përputhshmërisë), është një parashikim i arsyeshëm, lidhur me nivelin e mundshëm të shmangieve përse i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke pasur parasysh tre komponentët e riskut të auditimit:

Risku i brendshëm, i shmangies nga përputhshmëria apo gabimeve, vlerësohet të jetë i mesëm për shkak të:

- Komplexitetit të kuadrit rregullator dhe kohës në të cilën është miratuar kjo bazë ligjore.
- Ndryshimet e shpeshta të strukturës organizative.

Risku i kontrollit është risku që një shmangie materiale (e rëndësishme) mund të ndodhë dhe që nuk parandalohet, zbulohet dhe korrigjohet në kohën e duhur, nga sistemet e kontrollit të brendshëm. Risku i kontrollit vlerësohet i mesëm duke qenë se ekzistojnë procedura të kontrollit me anë të konfirmimeve nga palë të treta gjatë zhvillimit të procedurës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Risku i moszbulimit është risku që auditimi të mos zbulojë shmangie materiale të ndodhura dhe që nuk janë parandaluar apo zbuluar dhe korrigjuar në kohën e duhur nga sistemi i kontrollit të brendshëm të njësisë, entit, departamentit, agjencisë, organizatës, institucionit, etj. Risku i moszbulimit do të jetë i ulët duke marrë parasysh nivelin e pranuar të riskut dhe riskun e vlerësuar të brendshëm dhe atë të kontrollit.²

-Nisur nga sa më sipër, nga vlerësimi i riskut të brendshëm (RB), riskut të kontrollit të brendshëm (RKB) dhe riskut të zbulimit (RZ), ku dy risqet RB dhe RKB, ndikojnë në aktivitetet e institucionit, kemi bërë kategorizimin e riskut të aktiviteteve dhe përzgjedhjen e kampionit të auditimit, të cilat gjykojmë të auditojmë, pasqyruar në tabelën nr.3, Kap. ÷Anekseto.

Struktura e kontrollit të brendshëm të njësisë që auditohet.

Siç e kemi theksuar edhe më sipër, riskun e kontrollit të brendshëm e kemi vlerësuar të mesëm, për arsye se ekzistojnë disa procedura të kontrollit të brendshëm, por dobësia vihet re në zbatimin e tyre.

▪ Sa më sipër, vlerësojmë se, DPAKU konsiderohet me risk të lartë, përse i përket natyrës së aktivitetit që kryen, ndjeshmërisë së lartë sociale që ka, ndërgjegjësimin e biznesit, në garantimin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit për konsum njerëzor dhe për kafshët.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

1. Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ka si mision garantimin e shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar, trajtimit, përpunimit, dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë.

2.DPAKU është e organizuar dhe funksionon sipas përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr.708, datë 09.09.2020.Drejtoria e Përgjithshme ka në varësi 12 Drejtori Rajonale në nivel Qarku.

Struktura e DPAKU është miratuar me Urdhrin nr.128, datë 26.10.2020 të Kryeministrit, dhe është e organizuar në nivel Drejtorie të Përgjithshme, Drejtor Drejtorie dhe Sektori. Niveli i drejtorisë së përgjithshme përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm (1 punonjës), i cili ka në varësi 2 Sektor (1.Sektorin e Auditit të Brendshëm dhe 2.Sektorin e Buxhetit), 4 Drejtori (1.Drejtorja e Vlerësimit të Riskut; 2.Drejtorja e Komunikimit të Riskut dhe Monitorimit; 3.Drejtorja e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit; 4.Drejtorja e Shërbimeve të Brendshme), si dhe 17 Sektor (Planifikimi Strategjik dhe Raportimi; Aktiviteti Shkencor dhe Komunikimi me RASFF; Vlerësimi i Riskut dhe Statistikës; Koordinimit të Shërbimit Laboratorik; Informimi Publik dhe Koordinimi Ndërinstitucional; Komunikimit të Riskut dhe Ndërgjegjësimit të Biznesit; Monitorimit dhe Hetimit Ushqimor; Koordinimit të Kontrollit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore; Koordinimit të Kontrollit të Ushqimit për Kafshë dhe OBU; Licencimit dhe Dokumentacionit të Operatorëve të Biznesit; Koordinimit të Kontrollit në PIK; Shërbimeve të Brendshme dhe Prokurimeve; Ankesave Administrative dhe Gjyqësore; Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit; Asistencës Teknike dhe Trajnimeve), pra në total në organikën e DPAKUjanë 118 punonjës.

DPAKU ka si funksion:

a) koordinon planifikimin dhe kryerjen e kontrollit zyrtar të ushqimeve, ushqimeve për kafshë, inputeve bujqësore, veprimtarive prodhuese të duhan-cigareve, si dhe për kontrollin në pikën e

²Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli 4.3.2 - Për të ruajtur nivelin e riskut të auditimit (deri 5 %) të përcaktuar në politikat audituese të KLSH-së, sa më i lartë të vlerësohet nga audituesit niveli i riskut të brendshëm dhe/ose të kontrollit, aq më i ulët duhet të jetë risku i mos zbulimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETËVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

- inspektimit kufitar të shëndetit të kafshëve, produkteve mjekësore veterinarë dhe mbrojtjen e bimëve;
- b) unifikon praktikat e kontrollit zyrtar të ushqimeve, ushqimeve për kafshë, inputeve bujqësore, veprimtarive prodhuese të duhan-cigareve, si dhe për kontrollin në pikën e inspektimit kufitar të shëndetit të kafshëve, produkteve mjekësore veterinarë dhe produktet e mbrojtjes së bimëve;
- c) drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të autorizuar të sistemit të kontrollit zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë;
- ç) siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar, brenda ose jashtë vendit, në rastin e pamundësisë së kryerjes së tyre nga laboratorët e autorizuar të kontrollit zyrtar;
- d) drejton procesin e vlerësimit të riskut në fushën e sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë;
- dh) kryen studime shkencore të nevojshme dhe përgatit mendimin shkencor paraprak për nxjerrjen në treg të OMGJ-ve dhe/ose ushqimeve të reja;
- e) siguron mbështetje teknike e administrative për të siguruar veprimtarinë e komitetit shkencor dhe të paneleve shkencore;
- ë) përgatit raportin vjetor për veprimtarinë e AKU-së;
- f) përgatit planin e punës dhe buxhetin afatshkurtër e afatmesëm të AKU-së;
- g) administron dhe menaxhon për Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtoritë rajonale burimet pasurore, njerëzore, çështjet ligjore, automatizimin e proceseve të brendshme operative;
- gj) mbikëqyr buxhetin, administrimin financiar, mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e auditimit të brendshëm.

III.2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

II.2.1. Auditimi mbi procedurën e ndjekur, nga marrja e njoftimit nëpërmjet sistemit RASFF (sistemi i informimit të shpejtë për ushqim dhe ushqim për kafshë) për përdorimin e paautorizuar të substancës “oksid etileni” në prodhimin e produktit “akullore” (importuar dhe tregtuar në tregun shqiptar), deri në inspektimin, bllokimin, tërheqjen nga tregu dhe asgjësimin e saj.

Njoftimet nga Sistemi RASFF mbi prezencën e substancës së paautorizuar (oksid etileni) në akulloret e prodhuar në Francë.

Sistemi RASFF ka informuar autoritetet përgjegjëse për sigurinë ushqimore të vendeve anëtare të BE, por edhe vendet jo anëtare që kanë marrëveshje me këtë organizatë duke përfshirë edhe Shqipërinë, nëpërmjet AUK-së, mbi prezencën e substancës së paautorizuar të **“oksid etilenit”** në stabilizuesin *lygomme*, i përdorur për prodhimin e akullores nga Franca.

Njoftimi i parë është bërë nga autoriteti i sigurisë ushqimore në Spanjë, i cili ka raportuar prezencën e substancës së paautorizuar të oksidit të etilenit në përbërësit e akulloreve, për disa lote të importuara edhe në vendin tonë, përgjatë periudhës Mr-maj 2021 nga fabrika e prodhimit të akulloreve -Bnø -Snø dhe -Txø në Francë. Në këtë periudhë, sipas deklarimeve të AKU, kanë hyrë në vendin tonë 35,984.53 kg, nëpërmjet importit nga dy distributorë të këtyre llojeve akulloresh me lotet e deklaruar nga sistemi RASFF me prezencë të oksidit të etilenit. Nga auditimi dhe analizimi i praktikave doganore nga grupi i auditimit, rezultoi që, në vendin tonë kanë hyrë **38,721.45 Kg.**

Nga shqyrtimi i evidencës dokumentare, kryesisht komunikimit me e-mail të strukturave përgjegjëse pranë AKU për raportimet e RASFF dhe njoftimeve zyrtare të shfaqura në faqen zyrtare të saj, rezultoi se:

1. Më datë 27 korrik 2021 ora 15:58, Sistemi RASFF ka informuar shtete të ndryshme ku përfshihet edhe Shqipëria (si shtet distributor), nëpërmjet njoftimit nr.490467 me reference nr.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

2021.3976 me klasifikimin **“alert notification”**, mbi prezencën e substancës së paautorizuar (oksid etileni) në stabilizuesin Lygommeo në akulloret e prodhuara në Francë.

Prezenca e kësaj substance është zbuluar për herë të parë nga Spanja e cila ka njoftuar nëpërmjet sistemit RASFF.

Në seksionin ogjeneral documentso notld: 490467, në njoftimin nr.490467 me reference nr. 2021.3976 të datës 27.07.2021 gjendet skedari oMr_cod_lot.pdf, ku janë paraqitur nga kompania Mr Multisales Spain S.L. të gjitha lotet e akulloreve Mr që duhet të tërhiqen nga tregu. (Njoftimi paraqitet në Kapitullin **Anekse** oAneksi - nr.1.1, Foto nr.1)

2. Më datë 29 korrik 2021, Sistemi RASFF ka informuar 47 vende të ndryshme të botës duke përfshirë edhe Shqipërinë nëpërmjet njoftimit nr. 2021.3976 mbi kontaminimin e përbërësit Lygomme FM 4600 me Etilene Oxid, të disa loteve (Lot/ Batch) të akulloreve Tx, Sn dhe Bn të prodhuara në fabrikën Mr në Francë. Në këtë publikim, Shqipëria është njoftuar për ndjekje oFollow up notificationo fup2. (Njoftimi paraqitet në Kapitullin **Anekse** oAneksi - nr.1.1, Foto nr.2).

Korrespondenca me RASFF dhe me strukturat përgjegjëse të AKU-së.

Mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga AKU, kryesisht korrespondencës elektronike, konstatohet se:

1. Në vazhdim të njoftimeve dhe publikimeve në sistemin RASFF, për njoftimin nr.2021.3976 mbi prezencën e oksidit të etilenit në përbërësit e akullores së prodhuar në Francë.

RASFF ka përcjell, të dhëna të reja dhe të përditësuara në lidhje me njoftimet për Shqipërinë, krahas kësaj edhe me e-mail e datës 30.07.2021 ora 17:43. RASFF ka bashkëlidhur në attach dy dokumenta në formatin pdf.

a. Skedari 3976.pdf i datës 27.07.2021 ora 15:58;

b. dhe skedari 3976-fup2-AL.pdf i datës 30.07.2021 ora 09:41, si dokumenti i katërt i **njoftimeve alert**, në lidhje me informimin e prezencës së oksidit të etilenit në përbërësit e akullores së prodhuar në Francë me referencë 2021.3976, ku përfshihet edhe edhe Shqipëria.

-RASFF ka njoftuar Shqipërinë për ndjekjeo fup2.

-Në seksionin oProducts Operators Information documentso me notld: 491424 në skedarin oRecipient_list_MR_Albania.xlsx, jepen të dhëna për lotet që përmbajnë oksid etileni që janë importuar nga dy kompanitë Shqiptare nga fabrika e prodhimit të akulloreve në Francë. (Respektivisht pasqyruar në Kapitullin **Anekse** oAneksi - nr.1.1 o Tabela nr.1)

2. Më datë 30.07.2021 ora 23:49:50, specialistja e sektorit të aktiviteteve shkencore dhe komunikimit me RASFF znj. P.D i ka dërguar e-mail z. A.A me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit Zyrtar, duke e informuar mbi njoftimin e datës **29/07/2021**, nga sistemi RASFF i kategorisë: Alert me temë: oSubstancë e paautorizuar oksid etileni në stabilizuesin lygomme të përdorur për prodhimin e akullores nga Franca, me numër reference 2021.3976, në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje, fup2. Krahas kësaj ka bashkëlidhur dokumentat e RASFF dhe memon e përgatitur **Sekt. i Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF me objekt “Substancë e paautorizuar oksid etileni në stabilizuesin lygomme të përdorur për prodhimin e akullores nga Franca”**.

3. Pas njoftimit nga sektori i komunikimit me RASFF mbi prezencën e substancës së paautorizuar të oksid etilenit në përbërësit e akullores së importuar nga Franca dhe të hedhur në tregun Shqiptar gjatë periudhës Mr-maj 2021 nga dy distributor shqiptar.

Më datë **31.07.2021 ora 11:21z**. A.A, i ka përcjellë email-in e ardhur nga sektori i komunikimit me RASFF të datës o30.07.2021 ora 23:49, znj.A.M me detyrë inspektore e sektorit të koordinimit të kontrollit PIK dhe z.G.H me detyrë inspektor në sektorin e koordinimit të kontrollit të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe operatoreve të biznesit ushqimor.

4. Po në **datë 31.07.2021 ora 16:03**, Z.A.A ka informuar me e-mail Kryeinspektorin e AKU



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Tiranë z.M.N, dhe I.F inspektor pranë AKU Tiranë, mbi njoftimin e **datës 29.07.2021** nga sistemi RASFF i kategorisë alert me temë: ÷Substancë e paautorizuar oksid etileni në stabilizuesin lygomme të përdorur për prodhimin e akullores nga Franca me nr. Reference 2021.3976 në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje fup2.

5. E-mail-it të z.A.A të datës **31.07.2021 ora 11:21**, znj. A.M, i është përgjigjur më **datë 02.08.2021 ora 09:33**, duke i dërguar e-mail inspektoreve të Pikave të Inspektimit Kufitar të AKU-së mbi njoftimin e RASFF, në të cilën Shqipëria është etiketuar për ndjekjen fup2.

6. Më **datë 02.08.2021 ora 15:30**, znj. A.M nëpërmjet e-mail zyrtar ka informuar z.M.J, E.D, L.I, mbi lotet me prezencën e oksidit të etilenit në përbërësin e akullores për subjektin ÷Rö nga PIK Durrës dhe ÷M.Dö nga PIK Hani i Hotit.

7. Më **datë 02.08.2021 ora 15:46** znj. E.D me detyrë inspektor në sektorin e koordinimit të kontrollit të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe operatorëve të biznesit ushqimor, ka përcjellur në DRAKU Tiranë, informacionin e ardhur nga PIK, lidhur me importet e produkteve të sinjalizuar nga sistemi RASFF për Shqipërinë, për të bërë të mundur gjurmueshmërin e tyre.

8. Më **datë 9.08.2021 ora 17:45**, RASFF, ka dërguar njoftim të përditësuar për Shqipërinë pranë AKU-së, në lidhje me njoftimin me reference: 2021.3976 ÷ në të cilën Shqipëria është etiketuar për ndjekje, fup24.

9. Referuar informacionit të datës 25.08.2021 të AKU, për koordinatorin e antikorupsionit, rezulton se në datë **09.08.2021**, sektori i komunikimit me RASFF pranë DPAKU, ka informuar këtë të fundit me masat paraprake të marra pas verifikimit të situatës. Nga ku rezultoi se:

-OBU ÷Distributori 1ö ka importuar sasinë prej 8,568.03 kg dhe në magazinën qendrore të tij u gjendën 1751.9 kg produkte ende të pa shpërndara. Sasia tjetër e produktit ishte shpërndarë drejt supermarketeve të ndryshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. OBU ÷Distributori 2ö ka importuar sasinë prej 27,416.5 kg. dhe në magazinën qendrore të tij u gjendën 18121.3 kg. Sasia tjetër e produktit ishte shpërndarë drejt supermarketeve të ndryshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

10. Bazuar në proces verbalet e inspektorëve nr. AKU-Tr-2021-00442-2 datë 16.08.2021 mbi asgjësimin e sasisë së gjetur në magazinën ÷M.Dö e të grumbulluar, dhe atë me nr. AKU-Tr-2021-00442-1 të datës 19.08.2021, mbi asgjësimin e sasisë së gjetur në magazinën ÷Rö e të grumbulluar, arrihet në përfundimin që, procesi i gjurmimit, grumbullimit, tërheqjes dhe asgjësimit të produktit ÷akullorëö ka përfunduar më **datë 19.08.2021**.

11. Më datë **25.09.2021 ora 18:25** RASFF, në vazhden e njoftimeve për Shqipërinë, ka informuar ndjekjen sipas fup62.

12. RASFF më **datë 26.08.2021 ora 15:01**, informon AKU, se "Gjurmueshmëria për Shqipërinë nuk ndryshon". Ndjekja fup62 është informacion shtesë, ku Franca deklaroi se ka produkt ÷akullorëöqë kanë kaluar edhe nëpërmjet shtetit të Maqedonisë së Veriut.

Reagimi i strukturave përgjegjëse të AKU-së, në lidhje me njoftimet e sistemit RASFF mbi kontaminimin e akullores me oksid etileni.

I. Për sa më lart, është pasqyruar në mënyrë kronologjike gjithë veprimtaria e strukturave përgjegjëse të AKU-së për menaxhimin e situatave që lidhen me sigurinë ushqimore të produktit ÷akullorëö.

-Bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH dhe publikimeve në sistemin RASFF, u arritë në gjetjet e auditimit si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Publikimi i njoftimit të RASFF, me datë 27.07.2021

Titulli i gjetjes:

Mungesa e përcjelljes së njoftimit të RASFF të datës 27.07.2021, ku përfshihet edhe Shqipëria mbi prezencën substancës së paautorizuar të oksidit të etilenit në akullore, sektori i komunikimit me RASFF ó Strukturave përgjegjëse në AKU.

Sistemi RASFF, njoftimin e parë në lidhje me prezencën e substancës së paautorizuar të oksidit etilenit në përbërësin e disa loteve të akulloreve të prodhuara në Francë, e ka publikuar më **datë 27.07.2021 ora 15:58**. Në publikimin e këtij njoftimi në faqen e sistemit RASFF është përfshirë edhe Shqipëria, si një vend distributor i akulloreve të importuara nga Franca.

Ky njoftim është klasifikuar **“alert notification”**, si risk serioz me impakt në shëndetin e njeriut. Referuar nenit 2, pika 2 e rregullores nr. 3908 datë 29.09.2017 òPër procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFFò, parashikohet, se:

“Njoftimi “alert notification” nënkupton një njoftim që kërkon ose mund të kërkoj një veprim të menjëhershëm në një vend tjetër.”

Pra njoftimi i publikuar nga RASFF dhe i klasifikuar òalert notificationò kërkonte nga AKU që,të vepronte menjëherë pas publikimit të njoftimit 2021.3976, si vend importues i akulloreve me vend origjinë Francën, ku disa lote të akulloreve të prodhuara në fabrikën MrWCn: Rte de Saverne, Steinbourg, Francë, përmbanin oksid etileni.

Lista e këtyre loteve gjendet në versionin elektronik pdf, në linkun e seksionit ògjeneral documentsò notld: 490467, të njoftimin nr.490467 me reference nr. 2021.3976, të datës 27.07.2021 ora 15:58, me emrin òMr_cod_lot.pdfò. Të dhënat për lotet me përmbajtjen e oksidit të etilenit që duhet të tërhiqen nga tregu, janë pasqyruar nga kompania *Mr Multisales Spain S.L.*

Situata:

Nga auditimi konstatohet se:

Sektori i informimit të shpejt dhe mbikëqyrjes së tregut (sektori i aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF) nuk e ka përcjell njoftimin e datës 27.07.2021 ora 15:58 të RASFF strukturave përgjegjëse të AKU-së, duke vepruar në mospërputhje me përcaktimet e nenit 5 pika 2, të rregullores nr.3908 datë 29.09.2017 òPër procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFFò, si më poshtë:

òPika 2. Sektori i informimit të shpejt dhe mbikëqyrjes së tregut nga marrja e njoftimit, shpërndan njoftimin menjëherë dhe jo më shumë se 48 orë, kur njoftimi vjen në ditë pushimi për: Drejtorin e përgjithshëm, Drejtorin e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, si dhe Drejtorin e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit.

Pika 3. Njoftimi shpërndahet në forme shkencore dhe elektronike

Pika 4. Informacioni mbi njoftimin Alert do të përmbaj:

a) Njoftimin origjinal nga sistemi RASFF

b) Kjo pikë mungon në rregullore

c) Memon e përgatitur për njoftimin e marrë, si dhe masat që duhet të ndërmerren për eliminimin e rrezikutò

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Znj. A.Xh, në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF, e cila ka vepruar në mospërputhje me pikën 2, 3 dhe 4 të rregullores për procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFF, pasi nuk ka shpërndarë menjëherë njoftimin e RASFF për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Drejtorin e Përgjithshëm, Drejtorin e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, dhe Drejtorin e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve, megjithëse njoftimi është publikuar nga sistemi RASFF brenda orarit zyrtar të punës dhe jo ditë pushimi, pra më datë 27.07.2021 (e Martë) ora 15:58.

Kriteri:

Neni 5 pika 2, e rregullores nr.3908 datë 29.09.2017 òPër procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFFò

Ndikimi/Efekti:

Mos përcjellja menjëherë e njoftimit të klasifikuar òAlert notificationò me risk serioz për shëndetin e njeriut, ka ndikuar në shpejtësinë e reagimit të strukturave përgjegjëse për garantimin e sigurisë ushqimore për këtë produkt.

Shkaku:

Mungesa e zbatimit të rregullores nr.3908 datë 29.09.2017 òPër procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFFò për të përcjellje njoftimin e RASFF të datës 27.07.2021, i klasifikuar "**Alert notification**" me risk serioz për shëndetin e njeriut.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandime:

Nuk ka

Publikimi i njoftimit të radhës nga RASFF për Shqipërinë në lidhje me prezencën e substancës së paautorizuar të oksidit të etilenit, në përbërësit e disa loteve në akulloret e prodhuara në Francë dhe të futura në tregun tonë, është publikuar më **datë 29.08.2021**. Në këtë publikim, Shqipëria është njoftuar për ndjekje òFollow-up notificationò fup2, siç pasqyrohet në Kapitullin **Anekse** òAneksi - nr.1.1, Foto nr.2.

Sektori i aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF, nuk ka përcjell njoftimin e datës 29.08.2021, mbi ekzistencën e oksidit të etilenit në akulloret e prodhuara në Francë, importuar në Shqipëri, duke vepruar në mospërputhje me pikën 2, neni 2 të rregullores nr. 3908 datës 29.09.2017 òPër procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFFò.

"Njoftimi "alert notification" nënkupton një njoftim që kërkon ose mund të kërkoj një veprim të menjëhershëm në një vend tjetër."

Publikimi i njoftimit të RASFF, më datë 29.08.2021

Titulli i gjetjes:

Mungesa e përcjelljes së njoftimit datë 29.07.2021 për ndjekje fup2, të RASFF, ku përfshihet edhe Shqipëria, e furnizuar me produktin akullore, me prezencën e substancës së paautorizuar të oksidit të etilenit.

Më datë 29 korrik 2021, Sistemi RASFF ka informuar disa shtete të ndryshme të botës, duke përfshirë edhe Shqipërinë nëpërmjet njoftimit nr. 2021.3976 mbi kontaminimin e përbërësit Lygomme FM 4600 me Etilene Oxid, të disa loteve (Lot/Batch) të akulloreve Tx, Sn dhe Bn të prodhuara në fabrikën Mr në Francë. Në këtë publikim, Shqipëria është njoftuar për ndjekje òFollow-up notificationò fup2. Njoftimi paraqitet në Kapitullin **Anekse** òAneksi - nr.1.1, Foto nr.2.

Situata:

Nga auditimi konstatohet se:

Sektori i informimit të shpejt dhe mbikëqyrjes së tregut (sektori i aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF) nuk e ka përcjell këtë njoftim duke vepruar në mospërputhje me përcaktimet e nenit 5 pika 2, të rregullores nr.3908 date 29.09.2017 òPër procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFFò.

Gjithashtu, Sektori i informimit të shpejt dhe mbikëqyrjes së tregut (sektori i aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF) megjithëse në e-mail e datës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

30.07.2021, i referohet njoftimit të datës 29.07.2021 të RASFF, përsëri nuk ka përcjell njoftimin tek strukturat përgjegjëse, të përcaktuar në nenin 5 pika 2, të rregullores për procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFF, ku parashikohet se:

Pika 2. Sektori i informimit të shpejt dhe mbikëqyrjes së tregut nga marrja e njoftimit, shpërndan njoftimin menjëherë dhe jo më shumë se 48 orë kur njoftimi vjen në ditë pushimi për: Drejtorin e Përgjithshëm, Drejtorin e Vlerësimit dhe Komunikimit të riskut, si dhe Drejtorin e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit.

Pika 3. Njoftimi shpërndahet në formë shkresore dhe elektronike.

Pika 4. Informacioni mbi njoftimin Alert do të përmbajë:

a) Njoftimin origjinal nga sistemi RASFF;

b) *Shënim: pika "b" mungon në rregullore;*

c) Memon e përgatitur për njoftimin e marrë, si dhe masat që duhet të ndërmerren për eliminimin e rrezikut.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Znj. A.Xh, në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF dhe znj. P.D në cilësinë e specialistes së sektorit të aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF, e cila ka patur dijeni për publikimin e datës 29.07.2021 të RASFF mbi njoftimin për Shqipërinë, gjë që tregohet edhe në e-mail e **datës 30.07.2021 ora 23:49:50** me përmbajtjen, si më poshtë:

From: P.D

Sent: Friday, July 30, 2021 11:49:50 PM

To: A.A

Cc: B.S; D.Q; A.Xh

Subject: RASFF 2021.3976 fup 2 ÷Substancë e paautorizuar oksid etileni në stabilizuesin lygomme të përdorur për prodhimin e akullores nga Francaö Përshëndetje!

Më lejoni t'ju informoj mbi njoftimin e **datës 29/07/2021**, nga sistemi RASFF i kategorisë: Alert me temë: ÷Substancë e paautorizuar oksid etileni në stabilizuesin lygomme të përdorur për prodhimin e akullores nga Francaö, me numër reference 2021.3976, në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje, fup2.

Kriteri:

Rregullorja nr.3908 date 29.09.2017 ÷Për procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFFö

Ndikimi/Efekti:

Mos përcjellja menjëherë e njoftimit të klasifikuar ÷Alert notificationö me risk serioz për shëndetin e njeriut, ka ndikuar në shpejtësinë e reagimit (2 ditë vonesë) të strukturave përgjegjëse në DPAKU, për garantimin e sigurisë ushqimore për këtë produkt.

Shkaku:

Mungesa e përcjelljes së njoftimit të RASFF të datës 29.07.2021, i klasifikuar **"Alert notification"** me risk serioz për shëndetin e njeriut, ku Shqipëria është njoftuar për ndjekje fup2.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandime:

Nuk ka

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar me shkresën nr.979/3 Prot., datë20.10.2021, është paraqitur observacion nga znj. A.Xh në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF dhe znj. P.D, në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

cilësinë e specialistes së sektorit të aktiviteteve shkencore dhe komunikimit me RASFF, të cilat kanë paraqitur observacionin si më poshtë:

Observacion:

Çdo njoftim i ardhur nga Sistemi RASFF i njoftohet pikës së kontaktit në Sektorin e Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF vetëm nëpërmjet email-it. Në emailbashkangjitur, gjendet informacion i detajuar dhe gjurmueshmëria e produkteve që paraqesin problem për shëndetin e konsumatorit.

Pika e Kontaktit në Sektorin e Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF, nuk ka pasur asnjë njoftim me email në datat 27/07/2021 dhe 29/07/2021. Emaili i vetëm që kemi nga RASFF në lidhje me rastin konkret, është i datës 30/07/2021 ora 18:00, i cili është përcjellë po të njëjtën ditë. Kjo gjë, është lehtësisht e verifikueshme, sepse çdo email i dërguar lë gjurmë në serverat e AKU. Informacioni i gjendur në dritaren e RASFF nuk është i mjaftueshëm për ndjekjen e gjurmueshmërisë dhe marrjen e masave konkrete nga AKU.

Përsa i përket gjetjeve tuaja në lidhje me emailin ku citohet data 29.07.2021, duam të sqarojmë edhe njëherë se bëhet fjalë për një lapsus për shkak të shpejtësisë. MEMO bashkangjitur email-it mban datën 30.07.2021, datë në të cilën jemi njoftuar nga RASFF.

Gjatë vitit 2021, Shqipëria është njoftuar rreth 36 herë nga Sistemi RASFF dhe në të gjitha rastet, informacioni është dërguar i detajuar me email. Data e dërgimit në Shqipëri, nuk korrespondon me datën e njoftimit parësor në sistem, për arsye se Komisioni European bën verifikimet e nevojshme të bazës ligjore referuar Ligjit European të Ushqimit (EC) No 178/2002, para se të dërgojë gjurmueshmërinë. Duke marrë në shqyrtim vetëm një rast të izoluar, pa marrë në konsideratë veprimtarinë rutinë në rastet e njoftimeve nga Sistemi RASFF, nuk mund të kuptohet se si procedohet me rastet enjoftimeve. Më poshtë, do të gjeni korrespondencën e Sektorit të Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF, e cila ishte parashtruar në observacionet tona dhe nuk është marrë parasysh në ProjektRaportin tuaj.

Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:

-Për sa janë përcjellur në observacion, kemi të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur në Projekt Raportin e Auditimit.

II. Grupi i auditimit, në lidhje me vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së strukturave përgjegjëse të AKU-së, mbi menaxhimin e situatës të informuar nga RASFF të klasifikuar òAlert notificationò, për akulloret e importuar nga Franca, auditoi vendimmarrjet dhe plan-veprimin e ndjekur nga AKU, për reagimin në kohë në lidhje me identifikimin, tërheqjen dhe asgjësimin e tyre dhe në të njëjtën kohë informimin e publikut mbi sigurinë ushqimore.

Titulli i gjetjes:

Pasiviteti i veprimeve të ndjekura nga strukturat drejtuese të AKU në lidhje me menaxhimin efektiv të situatës të klasifikuar òAlert notificationò nga RASFF, për akulloret e importuara me prezencë të oksidit të etilenit.

Nga auditimi konstatohet se:

a. Nuk u gjet evidencë dokumentare apo komunikim elektronik, i Drejtorit të Përgjithshëm me strukturat përgjegjëse, për menaxhimin e situatës së krijuar dhe të klasifikuar òAlert notificationò me risk serioz për shëndetin e njerëit, nga prezenca e paautorizuar e oksidit të etilenit në disa lote të akulloreve të importuara në vendin tonë, duke mos evidentuar gjurmë auditi të veprimeve të tij.

Situata:

Këto veprime janë në mospërputhje me VKM nr.708, datë 9.9.2020, për organizimin dhe funksionimin e AKU pika 8, ku parashikohet:

Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, përveç sa është parashikuar në ligjin përkatës për ushqimin, kryen detyrat e mëposhtme:

e) autorizon shpërndarjen e informacionit për publikun

f) nxjerr akte të brendshme për menaxhimin administrativ, financiar, të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

burimeve njerëzore dhe akte të tjera të brendshme të detyrueshme për nëpunësit e AKU-së, për realizimin e funksioneve të këtij institucioni;

b. AKU deri në përfundim të periudhës së auditimit datë 07.09.2021, nuk pati evidence mbi informimin e publikut, në lidhje me sigurinë ushqimore për produktet që kanë qarkulluar me probleme, sipas njoftimit të RASFF, duke vepruar në kundërshtim me piken 9 të rregullores së AKU.

Neni 9 pika h. Informon publikun për fushën e sigurisë ushqimore ...

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z.B.S, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU.

Kriteri:

VKM nr. 708, datë 9.9.2020, për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të ushqimit; Rregullorja e AKU; VKM nr. 708, datë 9.9.2020, për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të ushqimit pika 8

Ndikimi/Efekti:

Pasiviteti i veprimeve të Strukturave përgjegjëse të AKU, ka ndikuar në qarkullimin për një kohë më të gjatë në tregun shqiptar të akulloreve të kontaminuara me substancën e paautorizuar të oksid etilenit, duke ekspozuar më shumë konsumatorin vendas me këto produkte të klasifikuara si Alert notification me risk serioz për shëndetin e njeriut.

Shkaku:

Mos zbatimi i detyrimeve ligjore për të drejtat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandime:

Nga ana e AKU të merren masa për përmirësimin dhe hartimin e rregullores për procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFF duke reflektuar strukturën e re organizative të AKU-së dhe në përputhje me standardet e direktivës së fundit të BE për sistemin RASFF.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar me shkresën nr.979/3 Prot., datë 20.10.2021 është paraqitur observacion nga z. B.S në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, i cili ka paraqitur observacionin si më poshtë:

Observacion:

Drejtori i Përgjithshëm, në lidhje me konstatimet e Grupit të Auditimit të KLSH-së, ka paraqitur kundërshtit si më poshtë vijon:

a. Për sa i takon njoftimit për konsumatorin në lidhje me rastin konkret, sipas rregullores nr.3908 datë 29.09.2017 për procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFF, neni 8 parashikon:

“Për çdo rast njoftimi nga sistemi RASFF, sektori i informimit të shpejtë dhe mbikëqyrjes së Tregut, nëpërfundim të procesit për të gjitha rastet e njoftimeve plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe përditëson bazën e të dhënave të këtij sistemi, si dhe e pasqyron si njoftim në faqen e web-it të AKU-së.”

Ky njoftim është bërë brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e cituar më lart.

Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:

-Për sa janë percjellur në observacion, kemi të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur në Projekt Raportin e Auditimit.

Veprimet operationale të Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë (DRAKU) në vijim të komunikimit nga DPAKU:

-Nëpërmjet komunikimit të bërë me email-in zyrtar datë **02.08.2021, ora 15:46**, DPAKU (Sektori i koordinimit të kontrollit të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe operatorëve të biznesit ushqimor), i percjellë DRAKU Tiranë informacionin e nevojshëm, për kryerjen e inspektimeve pranë dy subjekteve “**R**” shpk dhe “**M.D**” shpk, të cilat kanë importuar produktin “**Akulllore**” dhe më konkretisht Lot-et e këtij produkti, ku është **identifikuar** përmbajtja e substancës së paautorizuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

“Oksid etileni”.

-Në këtë komunikim, DRAKU Tiranë, i është përcjellë informacioni i Pikave të Inspektimit Kufitar të DRAKU Durrës (Porti Detar Durrës) dhe DRAKU Shkodër (Hani i Hotit), mbi importet e kryera të Lot-eve të produktit ÷Akullorë Sn, Tx dhe Bnö, cilësuar jo i sigurt për konsum.

-Referuar informacionit të PIK-ut Durrës dhe Shkodër, rezulton se, produkti ÷Akullorë Sn, Tx dhe Bnö me përmbajtje ÷Oksid etileniö, është importuar nga dy subjektet e mësipërme, përgjatë periudhës **01.03.2021 – 22.05.2021**.

-Në vijim përgjatë datave 03.08.2021 ó 19.08.2021 nga DRAKU Tiranë, në 2 subjektet M.D dhe R, janë kryer 6 inspektime gjithësej (3 për secilin prej tyre).

-Përgjatë këtyre inspektimeve, nga inspektorët përkatës, është bërë verifikimi i peshës së importuar të produktit ÷akullorëö, shitur, kthyer nga tregu, si dhe në përfundim asgjësimi i peshës gjëndje dhe asaj të kthyer.

▪ Nga shqyrtimi i dokumentacionit, praktikave të importit, inspektimet e kryera pranë dy subjekteve, rezultuan gjetjet, si më poshtë vijon:

Titulli Gjetjes Situata	i Pesha e importuar e produktit ÷akullorëö nga dy subjektet M.D dhe R. Nga përlogaritja e grupit të auditimit të KLSH, të sasisë së importuar rezultoi se: a.Të dy subjektet kanë bërë 6 importe, me peshë totale neto 38,721.45 Kg/38.7 Ton , respektivisht 30,153.92 Kg nga ÷M.Dö dhe 8,568.03 Kg nga ÷Rö, (pasqyruar në tabelën, Kapitulli Anekse “Aneksi-2.1ö); b.Ndërkohë sipas të dhënave të AKU-së, janë importuar 35,984.53 Kg/35.9 Ton . Pra siç shihet, pas përlogaritjes së grupit të auditimit të KLSH rezulton se, janë importuar 2.7 Ton më shumë akullorë. Diferenca 2.7 Ton tregon se, në vendin tonë, kanë hyrë më tepër akullorë me përbërësin e oksidit të etilenit.
Kriteri	Nga kjo sasi, grupi i auditimit ka dokumentuar vetëm 2 Ton shitje. Sasia tjetër prej 700 Kg është e padokumentuar dhe përfaqëson një sasi që nuk i dihet destinacioni ³ . -Shkronjën ÷çö të nenit 38 në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 ÷Për ushqiminö, i ndryshuar; -Shkronjën ÷bö të nenit 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ÷Për inspektimin në Republikën e Shqipërisëö; -Pikat 1, 3, 13, dhe 16 të Kreut III, pikën 2 të Kreut V, pikat 1 dhe 2 të Kreut VI të VKM nr.760, datë 16.9.2015 ÷Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimorö.
Ndikimi/Efekti	Nuk është pasqyruar saktë informacioni mbi peshën e produktit ÷akullorëö të importuar në Shqipëri, pasi janë importuar më shumë nga pesha e deklaruar nga AKU; Pesha e konsumuar e produktit ÷akullorëö është më e madhe, nga ajo e deklaruar nga AKU, janë konsumuar 2 ton më shumë (pasqyruar në tabelën, Kapitulli Anekse “Aneksi-2.3ö).
Shkaku	Mungesa e shqyrtimit të plotë të dokumentacionit mbi gjurmueshmërinë e produktit, nga inspektorët e DRAKU, si dhe pasaktësitë në informacionin e pasqyruar në sistemin e gjurmueshmërisë së dy subjekteve, për produktin ÷Akullorëö.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandime	Nuk ka

³Shkronja ÷çö, neni 38 në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 ÷Për ushqiminö, i ndryshuar;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Titulli i Gjetjes Vendimmarrja e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, në procedurën e ndjekur, nga marrja e njoftimit nëpërmjet Sistemit RASFF (Sistemi i informimit të shpejtë për ushqim dhe ushqim për kafshë) për përdorimin e paautorizuar të substancës oksid etileni në prodhimin e produktit òAkullorëo (importuar dhe tregëtuar në tregun Shqiptar), deri në inspektimin, bllokimin, tërheqjen nga tregu dhe asgjësimin e saj.

Situata

Si fillim:

1. Jemi përballë një situatë, ku një produkt jo i sigurt për konsum njerëzor òakullorëo, është futur në tregun Shqiptar;
2. Bashkimi Europian ka një sistem, të cilin e përdor për njoftime të ndryshme mbi produkte jo të sigurta për konsum.
3. Sistemi i Bashkimit Europian, i informimit të shpejtë për ushqim dhe ushqim për kafshë/ndryshe RASFF, ka njoftuar Autoritetin Kombëtar të Ushqimit në Shqipëri, se ky produkt është futur edhe në tregun Shqiptar;
4. Ky produkt është shpërndarë nga dy importuesit Shqiptarë, në të gjithë teritorrin e Republikës së Shqipërisë;
5. Në këto kushte, për gjurmimin e produktit akullorë në subjektet e furnizuara dhe parandalimin e riskut për shëndetin e konsumatorit (duke parandaluar shitjen e sa më shumë akullorë), është e nevojshme kryerja e inspektimeve jashtë planit të miratuar;
6. Për të kryer këto inspektime, Drejtori i Përgjithshëm duhet të urdhërojë kryerjen e inspektimeve jashtë planit të miratuar.

Më konkretisht:

➤ Më datë **27 korrik 2021 ora 15:58**, Sistemi RASFF ka informuar shtete të ndryshme ku përfshihet edhe Shqipëria (si shtet i furnizuar me produktin akullorë), nëpërmjet njoftimit nr.490467 me reference nr. 2021.3976 me klasifikimin **“alert notification”**, mbi prezencën e substancës së paautorizuar (oksid etileni) në akulloret e prodhuara në Francë.

Prezenca e kësaj substance është zbuluar për herë të parë nga Spanja e cila ka njoftuar nëpërmjet sistemit RASFF.

Në seksionin ògjeneral documentsö (sistemi RASFF) notld: 490467, në njoftimin nr.490467 me reference nr. 2021.3976 të datës 27.07.2021 gjendet skedari òMr_cod_lot.pdfö, janë paraqitur nga kompania Mr Multisales Spain S.L., të gjitha lotet e akullorëve Mrqë duhet të tërhiqen nga tregu.

➤ Më datë **29 korrik 2021**, Sistemi RASFF ka informuar 47 vende të ndryshme të botës duke përfshirë edhe Shqipërinë nëpërmjet njoftimit nr. 2021.3976 mbi kontaminimin me oksid etileni të disa loteve (Lot/Batch) të akullorëve Tx, Sn dhe Bn të prodhuara në fabrikën Mr në Francë. Në këtë publikim, Shqipëria është njoftuar për ndjekje òFollow up notificationö fup2.

Vec sa më sipër, RASFF ka përcjellë të dhëna, të reja dhe të përditësuara në lidhje me njoftimet për Shqipërinë, edhe me e-mail e datës 30.07.2021 ora 17:43 (në të cilin janë njoftuar disa persona, duke filluar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, Përgjegjësi i sektorit të Komunikimit me RASFF, etj). Në këtë email, RASFF ka bashkëlidhur dy dokumenta.

1. Skedari 3976.pdf i datës 27.07.2021 ora 15:58 (pra në njoftimin e parë);
2. dhe skedari 3976-fup2-AL.pdf i datës 30.07.2021 ora 09:41, si dokumenti i katërt i **njoftimeve alert**, në lidhje me informimin e prezencës së oksidit të etilenit në përbërësit e akullores së prodhuar në Francë me referencë 2021.3976, ku përfshihet edhe edhe Shqipëria.

-RASFF ka njoftuar Shqipërinë për ndjekjeó fup2.

-Në seksionin òProducts Operators Information documentsö me notld: 491424 në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

skedarin *Recipient_list_MR_ALBANIA.xlsx*, jepen të dhëna për lotet që përmbajnë oksid etileni që janë importuar nga dy kompanitë Shqiptare nga fabrika e prodhimit të akulloreve në Francë.

➤ Më **datë 30.07.2021 ora 23:49:50**, specialistja e sektorit të aktiviteteve shkencore dhe komunikimit me RASFF znj. P.D i ka dërguar e-mail z. H.A me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit Zyrtar në AKU, duke vendosur në ôccô edhe Drejtorin e Përgjithshëm të AKU-së, duke e informuar mbi njoftimin e datës **29/07/2021**, nga sistemi RASFF i kategorisë: Alert me temë: ôSubstancë e paautorizuar oksid etileni në stabilizuesin lygomme të përdorur për prodhimin e akullores nga Franca, me numër reference 2021.3976, në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje, fup2.

❖ **Pas këtij momenti dhe në zbatim të përcaktimeve ligjore, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, duhet të nxjerrë një urdhër të brendshëm, ku të urdhëroj 12 Drejtoritë Rajonale të AKU-së, për kryerjen e inspektimeve jashtë planit të miratuar me qëllim:**

1. Gjurmimin e plotë të produktit akullorë, tek subjektet në tregun shqiptar, të cilat janë furnizuar me këtë produkt;
2. Subjektet fundore që janë furnizuar me produktin ôakullorë, a janë njoftuar nga furnitori i tyre i parë (M.D/R);
3. Nëse po, a janë njoftuar të gjithë subjektet;
4. Nga dita që janë njoftuar, a kanë shitur akullorë;
5. A i kanë veçuar nga ambjentet e tregëtimit, akulloret jo të sigurt për konsum njerëzor;
6. Në datën që janë njoftuar nga furnitori i tyre, a ka patur konsumator të cilët kanë blerë akullorë, dhe nëse po, a i ka marrë masat e nevojshme subjekti, që të njoftojë me të gjitha mënyrat konsumatorin, që mos ta konsumojë akulloren;
7. A po e respektojnë detyrimin ligjor subjektet për kthimin e akullores në furnitorin e tyre.

Këtë veprim Drejtori i Përgjithshëm nuk e ka bërë, çka do të thotë se praktikisht, si pasojë e mosveprimit nga Drejtori i Përgjithshëm, si dhe bazuar në procedurën ligjore të miratuar për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, **detyrimet ligjore të mësipërme nuk janë verifikuar**, si dhe AKU është mjaftuar vetëm me inspektimin e dy importuesve të produktit ôakullorë dhe jo duke e ndjekur në çdo fazë gjurmueshmërinë e produktit, pra: 1.Import; 2.Shitje tek subjektet me shumicë/pakicë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; 3.Shitje tek konsumatori.

Kriteri

-Pikat 12 dhe 15 në nenin 3 ô**Nëse është e nevojshme**, kihen parasysh edhe zgjedhja e mundësive të përshtatshme **parandaluese** dhe ato të **kontrollit**, pikat 1 dhe 2 në nenin 6, pika 1 në nenin 7, shkronja ôbô në nenin 9, nenin 38 paragrafi ô**Kontrolli zyrtar** kryhet në **përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011** ôPër inspektimin në Republikën e Shqipërisë, përveç kur parashikohet shprehimisht në këtë ligj, nenin 39, pika 3 në nenin 40, shkronja ôdô në pikën 1 të nenit 62, pikën 2 të nenit 65 ôDrejtori i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, e përfaqëson at dhe vepron në emër të saj. **Ai është përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë** së institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë-së, **në përputhje me legjislacionin në fuqi**, në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 ôPër ushqimin, i ndryshuar;

-Shkronja ôaô në pikën 2 të nenit 4, shkronjën ôcô dhe ôçô të pikës 1 në nenin 25 ôPërjashtimisht, **një inspektim konkret mund të autorizohet jashtë programit** të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

inspektimit në rastet kur: c) si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik shqiptar **apo një shtet tjetër a një organizatë ndërkombëtare**, konsiderohet se është i nevojshëm fillimi i një inspektimi; ç) ndodhja e ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve kanë cenuar apo **mund të cenojnë jetën a shëndetin e njerëzve**, kafshëve apo mjedisinö, pikën 1 të nenit 27^o Procedimi administrativ i inspektimit **fillon, si rregull**, me **lëshimin e autorizimit** të inspektimit nga kryeinspektori...^o, shkronjën ^oa të pikës 1 në nenin 33^o Vendi i inspektimit përcaktohet në autorizim. Vendi i inspektimit mund të jetë: a) **kudo** ku kryen veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit dhe **ndodhen faktet që lidhen** me respektimin apo mosrespektimin e kërkesave ligjore, në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ^oPër inspektimin në Republikën e Shqipërisë;

-Pikën 3 në Kreun I, ^oAKU-ja e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit **dhe ka fushë përgjegjësie sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë në të gjithë zinxhirin e saj**...^o, shkronjën ^ob të Kreut II ^otë organizojë punën **për kryerjen e veprimtarisë inspektuese** në përputhje me fushat e saj të përgjegjësisë, shkronjat ^of dhe ^ok të pikës 8 të Kreut III, shkronjën ^ob në pikën 13 të Kreut III ^olëshon autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit **apo të akteve/urdhrave të nxjerrë nga drejtori i Përgjithshëm**, në VKM nr.708, datë 09.09.2020, ^oPër organizimin dhe funksionimin e AKU-së;

-Pikën 2 në Kreun VI të VKM nr.760, datë 16.9.2015 ^oPër kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor;

-Pikat 1 dhe 2 në Kreun I ^oKjo rregullore ka si objekt përcaktimin e rregullave për kryerjen e inspektimeve, **bazuar në një procedurë administrative të rregullt ligjore**....., që përfshin:

a) **Kryerjen e veprimtarisë inspektuese me dokumente standarde**, listë verifikimi dhe kartën digjitale të inspektorit, pikën 10 në Kreun III ^oKryeinspektori në nivel qendror, **mund të urdhërojë kryeinspektorin e një drejtorie rajonale**, të kryejë procedurë inspektimi të posaçëm, duke përcaktuar në urdhër kohën e kryerjes së inspektimit, fushën apo subjektin që do të inspektohet, në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 10.8.2018 ^oPër miratimin e rregullores, ^oPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ.

Ndikimi/Efekti Nuk dokumentohet nëse është shitur produkti ^oakullorë nga data e marrjes së njoftimit deri në kryerjen e inspektimit;

Nuk dokumentohet nëse është konsumuar nga produkti ^oakullorë nga data e marrjes së njoftimit deri në kryerjen e inspektimit;

Nuk dokumentohet nëse subjektet që janë furnizuar me akullorë, janë njoftuar nga furnitori i tyre ^oM.D^o/^oR^o

Nuk dokumentohet nëse janë njoftuar të gjithë subjektet që janë furnizuar me produktin ^oakullorë;

Nuk është ndjekur gjurmimi i plotë i produktit akullorë në çdo fazë të qarkullimit të saj, pra: 1.Import; 2.Shitje tek subjektet me shumicë/pakicë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; 3.Shitje tek konsumatori.

Nuk dokumentohet nëse e kanë respektuar detyrimin ligjor subjektet për kthimin e akullores në furnitorin e tyre.

Shkaku Mosveprim i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së

Rëndësia E Lartë

Rekomandime Nuk ka



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETËVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Observacion: Nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU, z.B.S, me shkresën nr.979/3 prot., datë 20.10.2021 është bërë observacion lidhur me konstatimin e grupit të auditimit si më sipër, për mosnxjerrjen e urdhrin të brendshëm për 12 DRAKU Rajonale. Në mënyrë të pëmbledhur: Zbatimi i ligjit nuk mund të pengohet nga nxjerrja apo jo e një urdhëri të brendshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së, ai është detyrim për të gjithë punonjësit e AKU-së. Të gjitha procedurat standarde të operimit janë të konsoliduara në ligjin e ushqimit, VKM-në e funksionimit të AKU-së dhe rregulloren e brendshme.

Në këto kushte, Drejtoria e Përgjithshme informohet dhe mbikëqyr nëpërmjet punës së kryer nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve (DMRKI) të gjitha etapat e ndjekjes së rasteve të ardhura nga RASFF. Mosnxjerrja e urdhrin të brendshëm për të kryer një punë standarde nga punonjësit e AKU-së nuk mund të pengojë askënd të kryejë detyrat funksionale të parashikuara në ligjin dhe rregulloret e sipërpërmendura. Referenca ligjore që është bërë nga ana juaj, pika 1, neni 25 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 për inspektimin në RSH. Si rrjedhojë në po të njëjtin ligj, neni 27, pika 1, parashikohet se kur një inspektorat organizohet edhe në degë territoriale, lëshimi i autorizimit i delegohet drejtuesit të degës rajonale.

Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:

Lidhur me argumentin e dhënë nga z.B.S, Drejtoria e Përgjithshme e AKU, parashtojmë se:

1. AKU është institucioni që kryen kontrollin/inspektimin e respektimit të kërkesave ligjore për garantimin e ushqimit të sigurt dhe cilësor;
2. Këtë funksion e kryen në mënyrë të planifikuar/jo të planifikuar, pra rastet kur vijnë ankesa, njoftime nga sistemi RASFF, etj;
3. Në këtë rast jemi përball njoftimit Alert të ardhur nëpërmjet sistemit RASFF dhe në këto kushte është e nevojshme kryerja e një inspektimi;
4. Gjithashtu kemi një produkt òAkullorë, që është shpërndarë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
5. AKU e shtrinë juridiksionin e vetë në të gjithë territorin e RSH dhe ka fushë përgjegjësie sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë në të gjithë zinxhirin e saj;
6. Detyrimi ligjor për këtë produkt jo të sigurt për konsum njerëzor, është bllokimi, tërheqja nga tregu dhe asgjësimi i tij;
7. AKU është institucioni përgjegjës që përgjigjet para konsumatorit, se një ushqim jo i sigurt nuk duhet të qarkullojë në treg;
8. AKU është institucioni përgjegjës që për të hequr këtë ushqim nga tregu duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme;
9. Ligjvënësi ka përcaktuar një detyrim që operatorët e biznesit ushqimor, të kenë një sistem gjurmueshmërie të produktit, me qëllim që kur të jetë e nevojshme, pra një produkt jo i sigurt që është shpërndarë në treg, të identifikohet shpejtë dhe lehtë, me qëllim gjurmimin e tij;
10. Në vijim të këtij vendimi dhe të ligjit për ushqimin, ligjvënësi ka përcaktuar gjithashtu se për gjurmimin e ushqimit është përgjegjëse AKU;
11. AKU për të bërë gjurmimin e ushqimit duhet të ushtrojë kontroll/inspektim në ato subjekte që janë furnizuar me produktin jo të sigurt për konsum njerëzor;
12. Kontrollin/inspektimin, AKU e kryen bazuar në dokumentet standard të inspektimit, të cilat janë (autorizimi i inspektimit, listë-verifikimi, procesverbali, vendimi i ndërmjetëm, vendimi përfundimtar, etj);
13. Sa më sipër, sipas AKU, a mund të ushtrohet një procedurë ligjore vetëm nëpërmjet email-it?
14. Në këto kushte Drejtoria e Përgjithshme e AKU, për të garantuar zbatimin e plotë dhe pa pengesa të ligjit, nga institucioni që drejton, duhet të nxirrte një urdhër të brendshëm, ku të gjitha DRAKU-të rajonale të kryenin inspektime pranë subjekteve që ishin furnizuar me akullorë, për të verifikuar nëse:
 - a) Këto subjekte, a janë njoftuar nga furnitori i tyre;
 - b) Nëse po, a janë njoftuar të gjithë subjektet që janë furnizuar;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

- c) Nga dita që janë njoftuar, a kanë shitur akullore;
- d) A i kanë veçuar nga ambjentet e tregëtimit akulloret jo të sigurta për konsum njerëzor;
- e) Në datën që janë njoftuar nga furnitori i tyre, a ka patur konsumator të cilët kanë blerë akullore, dhe nëse po, a i ka marrë masat e nevojshme subjekti, që të njoftojë me të gjitha mënyrat konsumatorin, që mos ta konsumojë akulloren;
- f) A po e respektojnë detyrimin ligjor subjektet për kthimin e akullores në furnitorin e tyre. (Si mund të garantoni ju se, në ditën që është bërë njoftimi nga dy distributorët kryesor, subjektet e njoftuara, nuk kanë tregëtuar akoma nga ky produkt? Subjekti privat në çdo moment mund të argumentojë që nuk kam marrë njoftim nga furnitori im, ose nuk kam arritur të njihem në kohë me njoftimin, dhe ndërkohë kanë vazhduar shitjet. Praktikisht si dhe bazuar në procedurën ligjore të miratuar, ju si institucion jeni mjaftuar vetëm me detyrimin e dy furnitorëve që ata të njoftojnë subjektet, të cilat janë furnizuar me akullore prej tyre).

-Që të verifikohen të gjitha këto, duhet që të kryehet një procedurë administrative e miratuar dhe me dokumentet standard ligjor, e cila mos të ketë asnjë kundërshtim nga pala tjetër, si dhe të ruajë gjurmën e auditimit (dokumentacionin përkatës), pasi në këtë rast ju si drejtori e përgjithshme, por edhe drejtoritë rajonale, janë mjaftuar vetëm me atë që kanë shprehur inspektorët verbalisht, pra jo të dokumentuar, ku në këtë rast dokumentimi i inspektimit, bëhet nëpërmjet dokumenteve standard.

-Theksojmë se, vërtet nga Drejtori i Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit më datë 04.08.2021, z.A.A, u është dërguar email 12 Drejtorive Rajonale të AKU-së, për ndjekjen e rastit, por a ka kompetencë ligjore Drejtori i kësaj drejtorie, të urdhërojë Kryeinspektorët e Drejtorive Rajonale të AKU, për marrje masash? Në rregulloren e brendshme të AKU, nenin 15, për detyrat e Drejtorit të kësaj drejtorie nuk përcaktohet në asnjë rast se ai ka të drejtë të urdhërojë strukturat e mësipërme, por ai vetëm **bashkëpunon/koordinon** sipas rastit, ndërkohë që ndryshe përcaktohet në shkronjën òbò të nenit 12 të kësaj rregullore, lidhur me të drejtat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm të AKU. Përveç kësaj, edhe Kryeinspektorët në detyrat e tyre, shkronja òfò neni 39 i rregullores së brendshme, nuk mund të autorizojnë kontrolle jashtë planit në mungesë të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm.

Gjithashtu theksojmë se, edhe në strukturën e re të AKU, miratuar me urdhërin nr.128, datë 26.10.2020, DRAKU janë në varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe jo nga Drejtori të tjera pranë DPAKU.

-Sa më sipër observacioni i bërë nga z.B.S nuk merret në konsideratë.

Inspektimet e kryera pranë dy subjekteve M.D dhe R, si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes 1.Inspektimi datë 03.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00437762, pranë subjektit M.D.

Situata -Grupi i inspektorëve: Sh.K, N.M dhe M.Sh.
-Referuar informacionit të pasqyruar nga grupi i inspektorëve, **pesha e produkteve të importuar është e pasaktë**, dhe më konkretisht gabimet në llogaritje janë për dy produktet Sn Ex I B (1*24*66g) me Lot-in 107C1DOE02 dhe Tx Ex I B (1*24*47g) me Lot-in 108A3DOE01, importuar më datë 22.05.2021, për arsye se, nga grupi i inspektorëve, në peshat e dy produkteve të mësipërme janë përfshirë edhe peshat e këtyre produkteve (Sn dhe Tx) **por me tjetër Lot-e**, 111E2DOE02 dhe 112A3DOE01, ku theksojmë se në njoftimin e bërë nëpërmjet sistemit RASFF nr.2021.3976, **këto Lot-e nuk janë raportuar** me prezencë të substancës òksid Etileniò. Gjithashtu këto Lot-e nuk janë të pasqyruara edhe në faqen zyrtare të Kompanisë Mr.

-Konstatohet se pesha e produkteve gjetur gjëndje në subjekt dhe ajo e shitur, sipas informacionit të pasqyruar në procesverbalin e inspektimit, konkretisht gjëndje në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

subjekt **18,123.9 Kg** dhe shitur **9,295.6 Kg, nuk përputhet** me peshën gjithësej të bërë hyrje në subjekt deklaruar vetë prej inspektorëve. Pra nëse mbledhim peshën gjëndje me peshën e shitur, gjithësej bëjnë **27,419.5 Kg import** dhe jo 31,191.046 Kg. Theksojmë se sipas përlloraritjeve të grupit të auditimit (shitjet Tiranë, Durrës, Fier, Berat, Vlorë, Sarandë, Korçë, Elbasan, Shkodër, Burrel, Krujë, Peshkopi, Tropojë) subjekti ka shitur **11,200.7 Kg** òAkullorëo dhe ka patur gjëndje **19,477.22 Kg**.

-Konstatohet se nga shqyrtimi i dokumentacionit të gjurmueshmërisë, kryesisht të shitjeve për Qarkun e Tiranës dhe atë të Beratit, **ai nuk përmban informacion të saktë**. Konkretisht në shitjet e bëra në Qarkun Tiranë, të produktit **Bn - Bty Ex I B (1*24*51.6gx24)**, janë përfshirë edhe **96 koli të produkteve me datë skadence 31.12.2022**, ndërkohë që në praktikat e importit të këtij produkti, në datat 01.03.2021 dhe 22.05.2021, subjekti M.D, **nuk ka importuar produkt me emrin Bn - Bty Ex I B (1*24*51.6gx24) me datë skadence 31.12.2022**, por ka importuar:
a. Bn - Bty Ex I B (1*24*51.6gx24) me data skadence 31.10.2022 dhe 28.02.2022;
b. BTY I B MP (39.1g*6*14), **lloji tjetër i Bn**, me datë skadence 31.12.2022.

Për shitjet e bëra në Qarkun e Beratit, në brendësi të dokumentacionit pasqyrohen shitje të bëra në Qytetin e Elbasanit. Gjithashtu në dokumentacionin mbi shitjet e produktit, nuk pasqyrohen datat e shitjes së tij, detyrim ligjor lidhur me elementët që duhet të përfshijë sistemi i gjurmueshmërisë. Këto mangësi nuk janë përmendur aspak nga grupi i inspektimit, ku për më tepër Ligji nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqiminò, i ndryshuar, parashikon masë administrative ògjobëo për pasaktësitë në sistemin e gjurmueshmërisë.

-Konstatohet se në vendimin përfundimtar të inspektimit, **subjektit nuk i është lënë detyrimi** për njoftimin e subjekteve të cilat i ka furnizuar me produktin òAkullorëo, me qëllim kthimin e tij në magazinën e M.D, **si dhe njoftimin e konsumatorit final**, por i është dhënë masa administrative òParalajmërimò, që në këtë rast nuk përputhet me natyrën e problemit, pasi nuk mund të paralajmërosh një subjekt, i cili nuk e ka ditur që është furnizuar me një produkt të pasigurt, ndryshe do të ishte nëse subjekti e dinte që produkti ka qenë i pasigurt dhe më pas është furnizuar.

Kriteri Pikën 2 të nenit 24, shkronjën òçò të nenit 38, pikën 2 të nenit 43, shkronjën òio të pikës 1 në nenin 68, në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqiminò, i ndryshuar; Shkronjën òçò të pikës 2 në nenin 4, pikën 3 të nenit 6, shkronjën òdhò të pikës 2 në nenin 43, pikën 6 të nenit 48, nëLigjin nr.10433, datë 16.06.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëo;

Ndikimi/Efekti Pikat 1, 3, 13, dhe 16 të Kreut III, pikën 2 të Kreut V, pikat 1 dhe 2 të Kreut VI të VKM nr.760, datë 16.9.2015 òPër kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimorò.

Shkaku Pasqyrimi i pasaktë i peshës së importuar të produktit akullorë, 3,264 Kg më pak, e cila është pasqyruar në çdo fazë të procesit, deri në asgjesimin e produktit; Mungesa e njoftimit të konsumatorit.

Rëndësia Mosndjekja e saktë dhe e plotë e sistemit të gjurmueshmërisë së produktit;

Rekomandime Pasaktësitë e sistemit të gjurmueshmërisë nga subjekti i inspektuar.

Titulli i Gjetjes I lartë
Nuk ka

Situata 2.Inspektimi datë 10.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00441762, pranë subjektit M.D.
-Grupi i inspektorëve: G.H dhe S.L.

-Nga ky inspektim ka rezultuar se pesha totale e kthyer nga tregu gjatë datave 04,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

	<p>05, 06, 07, 08, dhe 09.08.2021 është 3,075.38 kg, si dhe duke i shtuar peshën gjëndje 18,121.3 Kg në subjekt, sipas inspektimit të datës 03.08.2021, gjithësej janë 21,196.68 Kg që do të asgjeshen brenda datës 17.08.2021. Pra subjekti, sipas të dhënave të inspektorëve, ka kthyer 6,220.22 Kg më pak nga sasia e shitur prej tij, çka do të thotë se nuk e ka respektuar detyrimin e lënë në inspektimin e datës 03.08.2021.</p>
Kriteri	Pikën 6 të nenit 48, në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 për inspektimin në Republikën e Shqipërisë;
Ndikimi/Efekti	Mungesa e vendosjes së masës administrative ogjebë ndaj subjektit.
Shkaku	Mos zbatim i përcaktimeve ligjore nga inspektorët.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandime	Nuk ka
Titulli i Gjetjes	3.Inspektimi datë 16.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00444262, pranë subjektit M.D. -Grupi i inspektorëve: G.H dhe S.L.
Situata	-Sasia e deklaruar nga subjekti për asgjësim për produktin Tx X I B (47g1*24) me Lot-et 104E3DOE01 dhe 104F1DOE01, nuk përputhet me sasinë e pasqyruar në tabelën përmbledhëse në MEMO-n e datës 10.08.2021, drejtuar Kryeinspektorit të DRAKU Tiranë, nga inspektorët G.H dhe S.L. Konkretisht sipas deklarimit të subjektit për produktin Tx X I B (47g1*24) me Lot 104E3DOE01, pesha për asgjësim është 992.37 Kg , ndërkohë sipas inspektorëve është 1,342.041 Kg , ose 349.67 Kg më tepër , si dhe për produktin Tx X I B (47g1*24) me Lot 104F1DOE01 sipas deklarimit të subjektit, pesha për asgjësim është 1,729.22 Kg , ndërkohë sipas inspektorëve është 1,379.55 Kg , ose 349.66 Kg më pak, nga deklarimi i subjektit (pavarsisht se pesha totale e subjektit me atë të grupit të inspektorëve, e cila do të asgjësohet nuk ndryshon). -Po kështu edhe për peshën e shitur dhe atë gjëndje të produktit BTY I B MP (39.1g*6*14) me datë skadence 31.12.2022. -Gjithashtu konstatohet se, në praktikën e inspektimit nuk administrohet dokumenti i transferimit të mbetjeve në Landfillin e Bushatit, në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në Landfillin e Bushatit).
Kriteri	Shkronjën 0ço të nenit 38, shkronjën 0iö të pikës 1 në nenin 68, nenin 69 në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 për ushqimin, i ndryshuar; Pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme; Urdhërin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 10.8.2018 për miratimin e rregullores, për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ, Shtojca 2. Pikat 1 dhe 2 të Kreut VI të VKM nr.760, datë 16.9.2015 për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrimi jo i saktë i situatës në subjektin e inspektuar; Mungesa e dokumentimit të plotë të procedurës së asgjësimit; Mungesa e marrjes së masës administrative ndaj subjektit, për pasaktësitë në sistemin e gjurmueshmërisë.
Shkaku	Mos zbatim i përcaktimeve ligjore nga inspektorët.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandime	DPAKU të marrë masat e nevojshme, që çdo procedurë asgjësimi, të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe: Procesverbali i asgjësimit i mbajtur nga inspektorët e tatimeve, mjedisit dhe ushqimit; Dokumenti i transferimit të mbetjeve; Fletë-dalja nga magazina e subjektit privat; Kontrata e shërbimit; Fatura tatimore e shërbimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill.

R

Titulli i Gjetjes	1.Inspektimi datë 03.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-0000437562, pranë subjektit R. -Grupi i inspektorëve: N.H dhe A.H.
Situata	-Referuar informacionit të pasqyruar nga grupi i inspektorëve, pesha e produkteve të importuar është e pasaktë , dhe më konkretisht gabimet në llogaritje janë për produktin Sn SNK X I B (1*24*66g) Rs Si Al me Lot 107C1DOE02, pasi pesha e këtij produkti sipas inspektorëve është 1,544.4Kg , ndërkohë sipas praktikës së importit pesha është 2,059.2 Kg , ose 515.6 Kg më tepër. -Konstatohet se nga shqyrtimi i dokumentacionit të gjurmueshmërisë, ai nuk përmban informacion të plotë , pasinuk pasqyrohen datat e shitjes së produkteve, detyrim ligjor lidhur me elementët që duhet të përfshijë sistemi i gjurmueshmërisë. Këto mangësi nuk janë përmendur aspak nga grupi i inspektimit, për më tepër Ligji nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqiminò, i ndryshuar, parashikon masë administrative ògjobëo për pasaktësitë në sistemin e gjurmueshmërisë.
Kriteri	Shkronjën òço të nenit 38, pikën 2 të nenit 43, shkronjën òio të pikës 1 në nenin 68, në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqiminò, i ndryshuar; Pikën 3 të nenit 6 nëLigjin nr.10433, datë 16.06.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò; Pikat 1, 3, 13, dhe 16 të Kreut III, pikën 2 të Kreut V, pikat 1 dhe 2 të Kreut VI të VKM nr.760, datë 16.9.2015 òPër kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimorò.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrimi i pasaktë i peshës së importuar të produktit akullore, 515.6 Kg më pak, e cila është pasqyruar në çdo fazë të procesit, deri në asgjësimin e produktit. Mungesa e njoftimit të konsumatorit.
Shkaku	Mosndjekja e saktë dhe e plotë e sistemit të gjurmueshmërisë së produktit; Pasaktësitë e sistemit të gjurmueshmërisë nga subjekti i inspektuar.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Nuk ka
Titulli i Gjetjes	2.Inspektimi datë 09.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00441062, datë 09.08.2021, pranë subjektit R. -Grupi i inspektorëve: N.H dhe A.H.
Situata	-Pesha e gjithësej e shitur e produkteve sipas inspektorëve është përlllogaritur gabim, për arsye se pesha e produktit SNK I B (12*6*48g) Mp BA HR prej 942.48 Kg është e pasaktë, pasi subjekti nga ky produkt ka importuar gjithësej 362.88 Kg, ose 579.6 Kg më pak, dhe nuk ka se si të shesë më shumë nga sa ka bërë hyrje. Në këto kushte sasia prej 579 Kg i zbritet sasisë së deklaruar nga AKU që është konsumuar, çka do të thotë se pesha e konsumuar e deklaruar nga AKU duhet të jetë 11,167.84 Kg dhe jo 11,747.44 Kg; -Nga ky inspektim ka rezultuar se pesha totale e kthyer nga tregu deri më datën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

	<p>09.08.2021 është 701.46 Kg, pra jo të gjithë sasinë e shitur, çka do të thotë se subjekti nuk e ka respektuar detyrimin e lënë në inspektimin e mëparshëm, për kthimin e sasisë së shitur. Në përfundim të këtij inspektimi subjekti ka gjëndje 2,460.56 Kg (1,759.1 + 701.46), që do të asgjesohen brenda datës 16.08.2021.</p> <p>-Konstatohet se në dosjen e inspektimit nuk administrohet njoftimi i bërë konsumatorit final, detyrim ky i përcaktuar në inspektimin e datës 03.08.2021, dhe për këtë ndaj subjektit duhet të ishte vendosur masë administrative ogjjobëo. Gjithashtu theksojmë se grupi i auditimit bëri verifikimin në faqen zyrtare të kompanisë òRö, ku rezultoi se nuk është bërë një njoftim i tillë (pasqyruar në Kapitullin AneksetòAneksi ó 2.4ö).</p>
Kriteri	<p>Pikën 2 të nenit 24, shkronjën òçö të nenit 38, pikën 2 të nenit 43, shkronjën òfö të pikës 1 në nenin 68, në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqiminö, i ndryshuar;</p> <p>Shkronjat òaö dhe òçö të pikës 2 në nenin 4, pikën 6 të nenit 48, nëLigjin nr.10433, datë 16.06.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëö;</p> <p>Pikat 1, 3, 13, dhe 16 të Kreut III, pikën 2 të Kreut V, pikat 1 dhe 2 të Kreut VI të VKM nr.760, datë 16.9.2015 òPër kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimorö.</p>
Ndikimi/Efekti	<p>Pasqyrimi i pasaktë i peshës së shitur të produktit akulllore, 579 Kg më tepër, e cila është pasqyruar peshën totale të konsumuar nga konsumatori.</p> <p>Moslajmërimi i konsumatorit nga subjekti i inspektuar.</p>
Shkaku	<p>Mosndjekja e saktë dhe e plotë e sistemit të gjurmueshmërisë së produktit;</p> <p>Mosmarrja e masave administrative ndaj subjektit të inspektuar.</p>
Rëndësia	<p>E lartë</p>
Rekomandime	<p>Nuk ka</p>
Titulli i Gjetjes	<p>3.Inspektimi datë 19.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-004471 ó 2, pranë subjektit R.</p> <p>-Grupi i inspektorëve: N.H dhe A.H.</p>
Situata	<p>-Sipas informacionit të pasqyruar në procesverbalin e inspektimit subjekti nga data 09.08.2021 ó 14.08.2021, janë kthyer edhe 579.85 Kg të tjera. Pra në total pesha e kthyer e produktit òAkullorëö të shitur nga R, sipas informacionit të pasqyruar nga inspektorët, është 3,040.41 Kg, çka do të thotë se nga shitjet e tij, subjekti në përfundim ka kthyer 5,527.68 Kg më pak.</p> <p>-Subjekti nuk e ka respektuar afatin e vendosur, që brenda datës 16.08.2021 të kryejë asgjesimin e produkteve, për të cilën inspektorët duhet të kishin marrë masë administrative ogjjobëo.</p> <p>-Gjithashtu konstatohet se në praktikën e inspektimit nuk administrohet dokumenti i transferimit të mbetjeve në Landfillin e Bushatit, në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në Landfillin e Bushatit).</p>
Kriteri	<p>Nenin 69 në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqiminö, i ndryshuar;</p> <p>Pikën 6 të nenit 48, nëLigjin nr.10433, datë 16.06.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëö;</p> <p>Pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 òPër miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshmeö;</p> <p>Urdhërin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 10.8.2018 òPër miratimin e rregullores, òPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativö, Shtojca 2.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Ndikimi/Efekti	Mungesa e dokumentimit të plotë të procedurës së asgjësimit; Mungesa e zbatimit të detyrimit ligjor të përcaktuar nga inspektorët e DRAKU; Vonesa e në realizimin e procedurës së asgjësimit të produkteve.
Shkaku	Mos zbatim i përcaktimeve ligjore nga inspektorët dhe subjekti i inspektuar.
Rëndësia	I Mesëm
Rekomandime	DPAKU të marrë masat e nevojshme, që çdo procedurë asgjësi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe: Procesverbali i asgjësimit i mbajtur nga inspektorët e tatimeve, mjedisit dhe ushqimit; Dokumenti i transferimit të mbetjeve; Fletë-dalja nga magazina e subjektit privat; Kontrata e shërbimit; Fatura tatimore e shërbimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i dy procedurave respektivisht të datës 16.08.2021 dhe të datës 19.08.2021, për asgjësimin e produktit òakullorë dhe depozitimin e mbetjeve të tyre në landfillin e Bushatit u konstatuan veprime në kundërshtim me nenin 69, të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqimin, i ndryshuar dhe shtojcën 2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 10.8.2018 òPër miratimin e rregullores, òPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ, pasi në të dy rastet nuk administrohet dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas kërkesave të pikës 4, të VKM nr.229, datë 23.04.2014 òPër miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme, si dhe kërkesave të Kreut VIII të VKM nr.452, datë 11.7.2012 òPër lëndfillet e mbetjeve, i ndryshuar, në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin, pra personi përgjegjës në landfillin e Bushatit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (10-27) të Raportit të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: DPAKU të marrë masat e nevojshme që, çdo procedurë asgjësi të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve të jenë: Procesverbali i asgjësimit i mbajtur nga inspektorët e tatimeve, mjedisit dhe ushqimit; Dokumenti i transferimit të mbetjeve; Fletë-dalja nga magazina e subjektit privat, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU nuk është nxjerrë urdhër i brendshëm për 12 Drejtoritë Rajonale të Ushqimit, me qëllim kryerjen e inspektimeve dhe ndjekjen e gjurmueshmërisë së produktit òakullorë deri tek subjektet e furnizuara me këtë produkt.Mosveprim i cili bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 12 dhe 15 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 6,në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 òPër ushqimin, i ndryshuar, shkronjën òa ò në pikën 2 të nenit 4, shkronjën òc ò dhe òç ò të pikës 1 në nenin 25, pikën 1 të nenit 27, shkronjën òa ò të pikës 1 në nenin 33, në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisë, pikën 3 në Kreun I, shkronjën òb ò të Kreut II, shkronjat òf ò dhe òk ò të pikës 8 të Kreut III, shkronjën òb ò në pikën 13 të Kreut III në VKM nr.708, datë 09.09.2020, òPër organizimin dhe funksionimin e AKU-së dhe pikën 2 në Kreun VI të VKM nr.760, datë 16.9.2015 òPër kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (10-27) të Raportit të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, të marrë masat e nevojshme që, për çdo rast të njoftimeve òAlert ò me risk serioz për sigurinë e produkteve ushqimorë, duke vlerësuar përhapjen në treg të produktit dhe gjurmueshmërinë e tij, të nxjerrë urdhër të brendshëm për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar të inspektimeve. Gjithashtu të merren masa për përmirësimin dhe hartimin e rregullores për procedurat e komunikimit për rastet e njoftimeve të ardhura nga sistemi RASFF duke reflektuar strukturën e re organizative të AKU-së dhe në përputhje me standardet e direktivës së fundit të BE për sistemin RASFF.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

C.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

Mbështetur në pikën 4 (Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së emërohet dhe lirohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit) dhe shkronjën òdhò të pikës 5 (Drejtori i Përgjithshëm lirohet ose shkarkohet nga detyra kur kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës) në VKM nr.708, datë 09.09.2020 òPër organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimitò, i rekomandoj Ministrin të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, fillimin e procedurës për propozimin në Këshillin e Ministrave, lirim nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, **z.B.S**, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik, trajtuar më hollësisht në faqet nr.10-27.

C.1.1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa òdò dhe òeò dhe nenet 37, 141, dhe 153 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar, në kontratën individuale të punës, i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim”, ndaj:

- **Zj. Sh.K**, me detyrë Inspektor, për mangësitë e evidentuara në praktikën e inspektimit datë 03.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00437762, trajtuar në faqen nr.10-27 të Raportit të Auditimit.
- **Zj. N.M**, me detyrë Inspektor, për mangësitë e evidentuara në praktikën e inspektimit datë 03.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00437762, trajtuar në faqen nr.10-27 të Raportit të Auditimit.
- **Zj. S.L**, me detyrë Inspektor, për mangësitë e evidentuara në praktikën e inspektimit datë 10.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00441762, si dhe praktikën datë 16.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00444262, trajtuar në faqen nr.10-27 të Raportit të Auditimit.
- **Z. M.Sh**, me detyrë Inspektor, për mangësitë e evidentuara në praktikën e inspektimit datë 03.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00437762, trajtuar në faqen nr.10-27 të Raportit të Auditimit.
- **Z. A.H**, me detyrë inspektor, për mangësitë e evidentuara në praktikën e inspektimit 03.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-0000437562, datë 09.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00441062, si dhe praktikën 19.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-004471 ó 2, trajtuar në faqen nr.10-27 të Raportit të Auditimit.
- **Z. G.H**, me detyrë Inspektor, për mangësitë e evidentuara në praktikën e inspektimit datë 10.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00441762, si dhe praktikën datë 16.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00444262, trajtuar në faqen nr.10-27 të Raportit të Auditimit.
- **Z. N.H**, me detyrë Inspektor, për mangësitë e evidentuara në praktikën e inspektimit 03.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-0000437562, datë 09.08.2021 sipas procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-00441062, si dhe praktikën 19.08.2021 sipas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

procesverbalit të inspektimit nr.AKU-TR-2021-004471 ó 2, trajtuar në faqen nr.10-27 të Raportit të Auditimit.

▪ **Zj. A.Xh**, me detyrë Përgjegjëse e sektorit të aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF, për mangësitë e evidentuara në komunikimin AKU-me RASFF, trajtuar në faqen nr.10-27 të Raportit të Auditimit.

Vërejtje, për:

▪ **Zj. P.D**, me detyrë Specialiste e sektorit të aktivitetit shkencor dhe komunikimit me RASFF, për mangësitë e evidentuara në komunikimin AKU-me RASFF, trajtuar në faqen nr.10-27 të Raportit të Auditimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT

V.ANEKSE

Aneksi nr.1.1

Foto Nr.1

NOTIFICATION 2021.3976
Unauthorised substance (ethylene oxide) in lygomme stabiliser used in the manufacture of ice-cream from France
notified 27 JUL 2021 by Spain | last update 2 SEP 2021

Reference 2021.3976
Subject Unauthorised substance (ethylene oxide) in lygomme stabiliser used in the manufacture of ice-cream from France
Product type Food
Notification basis Company's own check
Classification Alert notification
E-commerce No
IRASFF link <https://webgate.ec.europa.eu/irasff/notification/view/490467>

Date of notification 27-07-2021 15:58:22
Distribution status Distribution to other member countries

(N) Notifying | (O) Origin | (D) Distribution
(FFUP) Flagged for Follow-Up | (FFA) Flagged For Attention

Organisations	N	O	D	FFUP	FFA
Albania					
Andorra					
Aruba					
Australia					
Austria					
Bahrain					
Belgium					
Bulgaria					
China					
Croatia					
Curaçao					
Cyprus					
Denmark					
Egypt					
Estonia					

Foto Nr.2

Follow-ups

Organisation	Type	Summary
Denmark	IM	Outcome of investigations and measures taken
France	IM	Outcome of investigations and measures taken
Finland	IM	Outcome of investigations and measures taken
European Commission		Not specified
Denmark	IM	Outcome of investigations and measures taken
Portugal		Additional information
Sweden	M	Measures taken
Bulgaria	IM	Outcome of investigations and measures taken
France		Corrigendum
Netherlands		Additional information

Products

Catégorie	Name	Brand	Sampling	Traceability	Measures taken
-----------	------	-------	----------	--------------	----------------

The company Mars has received several batches of Lygomme FM 4600 contaminated with EO. Mars has informed us of the use of these batches in its various Twix, Snickers and M&M's products. In France, the products are withdrawn and recalled from the market. The countries concerned by the distribution are: Oman, China, Sweden, Greece, Georgia, Germany, Norway, Latvia, Bulgaria, Italy, Switzerland, Australia, Spain, Lebanon, Iceland, Russia, United Arab Emirates, Albania, Monaco, Malta, Slovenia, Saudi Arabia, Jordan, Croatia, Kuwait, Turkey, Austria, Kazakhstan, Bahrain, Israel, Finland, Denmark, Belgium, Hungary, Egypt, Poland, United Kingdom, Cyprus, Ireland, Ukraine, Singapore, Portugal, Qatar, Serbia, Malaysia, Netherlands and Romania.

Burimi: RASFF



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Tabela nr.1. Lotet me përmbajtje oksid etileni te importuar nga dy kompanitë shqiptare

10	Client name	Material	Material Description	Batch/Lot	Best-Before Date
AL	Distributori 1	BG97G	BTY X I B 1*24*51.6g CyFiGrMtSe	010D2DOE02	28/02/2022
AL	Distributori 1	BG97G	BTY X I B 1*24*51.6g CyFiGrMtSe	048D2DOE02	31/10/2022
AL	Distributori 1	CB53D	BTY I B 14*6*39.1g Mp FR BE BA	102F3DOE02	31/12/2022
AL	Distributori 1	CB72Y	TX I B 12*6*34.2g Mp BA HR RS SL	047D1DOE01	31/10/2022
AL	Distributori 1	CR22T	TX X I B 1*24*47g AL RS PL	104E3DOE01	31/12/2022
AL	Distributori 1	CR22T	TX X I B 1*24*47g AL RS PL	104F1DOE01	31/12/2022
AL	Distributori 1	CR22T	TX X I B 1*24*47g AL RS PL	108A3DOE01	31/01/2023
AL	Distributori 1	CR42V	SNK X I B 1*24*66g RS SI AL	103E3DOE02	31/12/2022
AL	Distributori 1	CR42V	SNK X I B 1*24*66g RS SI AL	103F1DOE02	31/12/2022
AL	Distributori 1	CR42V	SNK X I B 1*24*66g RS SI AL	107C1DOE02	31/01/2023
AL	Distributori 2	BG97G	BTY X I B 1*24*51.6g CyFiGrMtSe	102D1DOE02	31/12/2022
AL	Distributori 2	BG97G	BTY X I B 1*24*51.6g CyFiGrMtSe	102D2DOE02	31/12/2022
AL	Distributori 2	CB61J	SNK I B 12*6*48g Mp BA HR	101F2DOE02	31/12/2022
AL	Distributori 2	CR22T	TX X I B 1*24*47g AL RS PL	104F1DOE01	31/12/2022
AL	Distributori 2	CR22T	TX X I B 1*24*47g AL RS PL	108A1DOE01	31/01/2023
AL	Distributori 2	CR42V	SNK X I B 1*24*66g RS SI AL	103F1DOE02	31/12/2022
AL	Distributori 2	CR42V	SNK X I B 1*24*66g RS SI AL	107C1DOE02	31/01/2023

Burimi: RASFF

Aneksi nr.2.1 òPër kategorizimin e riskut dhe përzgjedhjen e kampionit të auditimitò.

Tabela nr.2 Kategorizimi i riskut dhe përzgjedhja e numrit të kampionit për tòn audituar

Nr.	Aktiviteti	Niveli i Riskut	Kampioni i përzgjedhur
1	Marrja e njoftimit Alert nga sistemi RASFF dhe koha e reagimit	I Lartë	
2	Inspektimi i produktit me origjinë shtazore	I Mesëm - I Lartë	6 praktika

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.2.2 òImportet nga dy subjektetò.

Tabela nr.3 Importet M.D dhe R

Importe M.D - Produkti Akulllore, Pesha (Neto)⁴

				Data				
				01.03.2021	04.03.2021	10.03.2021	22.05.2021	PESHA NETO - 4 IMPORTE
				Kg	Kg	Kg	Kg	Kg
Pesha neto për 3 produktet		Total (I + II + III)		11,168.34	14,536.80	1,062	3,917.28	30,684.42
I				Kg	Kg	Kg	Kg	Kg
	Bn	Kodet	Lot	5,652.18	0	1,062	0	
	Sipas Lot-eve	BG97G	048D2DOE02	4,248		1,062		
		CB53D	102F3DOE02	873.18				
BG97G		010D2DOE02	531					
								9,237.18
II				Kg	Kg	Kg	Kg	Kg
	Tx Nr.Lot	Kodet	Lot	898.56	4,147.20	0	2,887.68	
	Sipas Lot-eve	CB72Y	047D1DOE01	898.56				
		CR22T	104E3DOE01		1,244.16			
		CR22T	104F1DOE01		2,903.04			
CR22T		108A3DOE01				2,887.68		
								7,933.44
III				Kg	Kg	Kg	Kg	Kg

⁴ Vlerat e mësipërme për të dy kompanitë janë marrë nga faturat e lëvrimit (Bon De livraison), të Kompanisë MrWrigley Francë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Sn Nr.Lot	Kodet	Lot	4,617.60	10,389.6	0	1,029.6	
<i>Sipas Lot-eve</i>	CR42V	103E3DOE02		2,308.8			16,036.80
	CR42V	103F1DOE02		8,080.8			
	CR42V	103F1DOE02	4,617.60				
	CR42V	107C1DOE02				1,029.6	

Importe R - Produkti Akulllore, Pesha (Neto)							
				Data		PESHA NETO - 2 IMPORTE	
				26.03.2021	26.04.2021		
				Kg	Kg	Kg	
Pesha neto për 3 produktet			Total (I + II + III)		5,479.23	3,088.80	8,568.03
I	Bn	Kodet	Lot	Kg	Kg	Kg	
	<i>Sipas</i>	<i>BG97G</i>	102D1DOE02	1,392.75	0	1,392.75	
	<i>Lot-eve</i>	<i>BG97G</i>	102D2DOE02	464.25			
			928.5				
II	Tx	Kodet	Lot	Kg	Kg	Kg	
	<i>Sipas</i>	<i>CR22T</i>	104F1DOE01	721.92	0	721.92	
	<i>Lot-eve</i>	<i>CR22T</i>	108A1DOE01	360.96			
			360.96				
III	Sn	Kodet	Lot	Kg	Kg	Kg	
	<i>Sipas</i>	<i>CB61J</i>	101F2DOE02	3,364.56	3,088.8	6,453.36	
	<i>Lot-eve</i>	<i>CR42V</i>	103F1DOE02	362.88			
		<i>CR42V</i>	103F1DOE02	942.48			
	<i>CR42V</i>	107C1DOE02	2059.2	3,088.8			

Burimi: Praktikat e importit të dy subjekteve, faturat e lëvrimit të produkteve

Aneksi nr.2.3 ÷Shitjet dhe konsumi nga dy subjektetö.

Shitjet, kthimet dhe konsumi nga qytetarët i produkteve të mësipërme.

Në tabelat e mëposhtme është pasqyruar pesha e shitur e produkteve (Bn, Sn dhe Tx) nga dy distributorët, ku për përllogaritjen e të cilave i jemi referuar dokumentacionit të gjurmueshmërisë të të dy subjekteve.

-Sipas dokumentacionit të gjurmueshmërisë dhe përllogaritjeve të grupit të auditimit, M.D ka shitur 11,207.2 Kg ÷Akullloreö dhe R ka shitur 6,720.7 Kg ÷Akullloreö. Produktet janë shitur kryesisht në Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Vlorë, Berat, Lushnje, Korçë, Shkodër, Sarandë, Krujë, Burrel, Peshkopi, Tropoj, Lezhë;

Tabela nr.4Shitjet M.D dhe R
M.D - Shitje deri më datë 02.08.2021

Produkti	Kodi	Lot-i	Shitje
			Kg
BTY E i b 1*51.6gx24 (Bn)	BG97G	048D2DOE02	2,730
		010D2DOE02	
BTY I b MP 39.1g*6*14 (Bn)	CB53D	102F3DOE02	348.1
TX E i b 1*24* 47 g	CR22T	104E3DOE01	2,533
		104F1DOE01	
		108A3DOE01	
TX E ic b MP34.2 gx6x12	CB72Y	047D1DOE01	64.6
SNK E i b 1*66g*24 (Sn)	CR42V	103E3DOE02	5,525
		103F1DOE02	
		107C1DOE02	
TOTAL M.D			11,200.7
R - Shitje deri më datë 03.08.2021			
Produkti	Kodi	Lot-i	Shitje
BTY E i b 1*51.6gx24 (Bn)	BG97G	102D1DOE02	1,392.75
		102D2DOE02	
TX E i b 1*24* 47 g	CR22T	104F1DOE01	721.92



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

		108A1DOE01	
SNK E i b 1*66g*24 (Sn)	CR42V	103F1DOE02	3,884.49
		107C1DOE02	
SNK I B 12*6*48g (Sn)	CB61J	101F2DOE02	362.88
TOTAL R			6,362.04
TOTAL shitje për dy Distributorët			17,569.24
(-) Kthimet për dy distributorët			4,356.69
TOTAL Konsumuar sipas Grupit të Auditimit (Shitje - Kthimet)			13,205.35
TOTAL Konsumuar sipas AKU			11,167.84
Diferenca			2,037.51

Burimi: DRAKU Tiranë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT